



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 1146 prot.

Tiranë, më 24.12. 2025

U R D H Ë R

Nr. 298, datë 24.12.2025

“Për pezullimin e procedurave të shortit gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin “C”, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13, germa “d” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 7 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual në Kolegjin e Posaçëm të Apelit”, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e procedurave të hedhjes së shortit për ankimet/kërkesat e regjistruara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën nga data 29.12.2025 deri më 12.01.2026¹.
2. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbeshtetëse të marrë masat për protokollimin, verifikimin, pranimin dhe regjistrimin e ankimeve/kërkesave në regjistrat përkatës, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën nga data 29.12.2025 deri më 12.01.2026².
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbeshtetëse, si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e web-it të Kolegjit.

KRYETARI



Sokol Çomo

¹ Data 12.01.2026 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.

² Data 12.01.2026 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.